



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë

“Bachelor” në “Gjuhë Angleze”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Leonard Danglli

2. Dr. Ergys Bezhani

Nëntor/2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “Gjuhë Angleze”, ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Angleze”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 300, datë 21.06.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	115
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë Angleze” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Ky departament ofron gjithashtu programet e studimit “Bachelor” në “Gjuhë dhe kulturë frënge” dhe “Master Profesional” në “Mësues i gjuhës angleze”.

Departamenti përbëhet nga 17 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 1 Profesor i Asociuar, 14 Doktorë të Shkencave dhe 2 Docentë. Ai u hap për herë të parë në vitin 1994 me miratimin e programit të studimit “Gjuhë Angleze”, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 300, datë 21.06.1994.

Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ofrohet me kohë të plotë, në 3 vite/6 semestra, me 180 ECTS, dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë e ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë Angleze”.

Në vitin akademik 19-20, programi i studimit mbulohet 98.5 % nga staf akademik me kohë të plotë. Në këtë program studimi janë aktivë 115 studentë, në të tre vitet akademike të këtij programi.

Ky program studimi i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm


Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, ka kaluar në disa faza:

1. Vlerësimi i brendshëm: Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit (*Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës*). Dosja përbëhet prej afro 136 evidencash, të cilat ofrojnë një pasqyrë të plotë të elementëve të programit të studimit;
2. Shqyrtimi i dokumentacionit dhe përgatitja e materialeve për vizitën në institucion: janë realizuar takime dhe diskutime nga ana e GVJ, është hartuar drafti paraprak, është dakordësuar agjenda e vizitës në Insitucion dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive;
3. Vizita në Institucion: u realizua në datat 12-13.10.2020. Sipas Agjendës së miratuar paraprakisht, janë kryer takime me: Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit; Grupin e Vetëvlerësimit; Përfaqësues të stafit akademik me kohë të plotë dhe kontratë të angazhuar në programin e studimit; Përfaqësues të studentëve të programit të studimit; Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor dhe Koordinatorin e projekteve Erasmus+; Qendrën e Karrierës dhe Alumni dhe Qendrën Rinore dhe Sportive; Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; Sekretarinë Mësimore, si dhe u realizua një vëzhgim i ambjenteve të Institucionit (auditoret, laboratorët, bibliotekën, zyrat e stafit, etj). Gjatë vizitës në Institucion, nga GVJ u kërkua një dokument shtesë, i cili u vu në dispozicion nga Koordinatori Institucional;
4. Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është bazuar në Manualin e Vlerësimit dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Raporti i vlerësimit të jashtëm pasqyron vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë për programin Bachelor, pjesë e Kodit të Cilësisë, të fokusuar në 6 fusha vlerësimi: 1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programit të studimit; 2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; 3. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; 4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistikë për realizimin e programit të studimit; 5. Studentët dhe mbështetja e tyre; 6. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit. Shkalla e përmbushjes së standardeve për çdo fushë, është përcaktuar bazuar në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, sipas niveleve: Standardet nuk përmbushen; Standardet përmbushen pjesërisht; Standardet përmbushen kryesisht; Standardet përmbushen plotësisht.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga: **Prof. As. Leonard DANGLLI** dhe **Dr. Ergys BEZHANI**. Në realizimin e këtij procesi vlerësimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako.

Më datë 23.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 56/34 Prot., datë 23.11.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 23.11.2020 përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1908 Prot., datë 24.11.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke shprehur dakordësinë me



vlërësimet dhe konkluzionet e parashtruara nga GVJ. Sa më lart, Raporti merr formën e tij përfundimtare.

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme të pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Angleze”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit në fjalë, rezulton se programet e studimit janë në harmoni me interesat kombëtare dhe i ndjekin ato në mënyrë rigorozë. Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat dhe misionin e UNIKO.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Përveç dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale që një student duhet të fitojë, programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” transmeton qartë edhe vlerat kulturore kombëtare.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në mënyrë që të fuqizojë studentët në përfitim të shprehive të nevojshme për një gamë të gjerë profesionale, duke qenë në një linjë me misionin, qëllimin e institucionit si dhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë edukative arsimore.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Vihet re një harmoni e natyrshme mes programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” dhe nevojave të tregut të punës, të cilat mbështeten në synimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit. <i>Shtojca 1.1; Shtojca 1.3; Shtojca 2.4; Shtojca 6.92</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Strategjia për zhvillimin e institucionit merr në konsideratë vlerat universale të të nxëniet të studentit, duke u mbështetur në përdorimin e qasjeve të ndryshme për kërkimin shkencor. Prandaj programi i studimit është përshtatur siç duhet me strategjinë në fjalë. Misioni i			



<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Departamentit të Gjuhëve të Huaja është pjesë e misionit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, brenda kuadrit të misionit të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar, emërtuar dhe zhvilluar sipas fushave prioritar të zhvillimit të UNIKO. Fushat e filologjisë dhe mësuesisë janë pjesë përbërëse e objektivave bazë të studimeve të ofruara nga UNIKO [E31]. Ato detajohen në emërtimet e programeve të studimit të ofruara: Bachelor në “Gjuhë angleze”, Bachelor në “Gjuhë dhe Kulturë Frënge” dhe Master Profesional “Mësues i gjuhës angleze”.</p> <p>Programi në tërësi, duke përfshirë mënyrën se si është organizuar dhe çfarë përmban, është në linjë me synimet, strategjinë e zhvillimit, objektivat e institucionit si dhe profilin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.</p> <p><i>Shtojca 1.20; Shtojca 1.21; Shtojca 2.1</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">√</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit në fjalë, si edhe të dhënave të vëna në dispozicion gjatë vizitës në institucion, rezulton se objektivat e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” janë në harmoni me formimin e studentëve në këtë program studimi, përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e tij.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” synon: përgatitjen e studentëve me formim të gjerë gjuhësor, letrar e kulturor rreth vendeve anglishtfolëse; zhvillimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese në stile, situata dhe regjistra të ndryshëm në gjuhë të huaj; nxitjen e mendimit kritik përmes një kurrikule me bazë kompetencat e të nxënit; pajisjen me aftësi të hulumtimit të burimeve të informacionit, të përpunimit të të dhënave dhe analizës; formimin e kompetencave gjuhësore, shkencore, psikopedagogjike, të cilat do të përmbushin objektivat e kualifikimit në shoqërinë e dijes, për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare</p>



prishme në sektorin përkatës.	dhe interesave kombëtare.			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p><i>Departamenti i Gjuhëve të Huaja nuk ka ndërmarrë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për këtë program studimi, pasi është program i ciklit të parë dhe nuk siguron punësim të menjëhershëm pas diplomimit. Megjithatë, GVJ rekomandon realizimin e një studimi tregu për programin e studimit, pasi kjo do të ndihmonte studentët në orientimin e tyre profesional. Të dhënat e përgjithshme të punësimit të studentëve të diplomuar në të janë mbledhur nga informacionet e vëna në dispozicion nga Drejtoritë Arsimore Rajonale të Korçës, Pogradecit dhe Ersekës, si dhe me anë të komunikimeve me alumni. Gjithashtu, ky program studimi ka qenë pjesë e gjurmimit të alumni të realizuar nga rektorati në vitin 2017. Programi në vetvete ka si qëllim garantimin e përfimit të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave të cilat realizohen nga objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit. Të gjithë këto aftësi të përgjithshme e bëjnë procesin e punësimit të studentëve më të lehtë.</i></p> <p><i>Shtojca 2.4; Shtojca 6.81; Shtojca 6.83</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Institucioni është i aftë për të ofruar një program studimi që synon formimin gjuhësor të studentëve në një fushë të caktuar dhe e përvetëson këtë aftësi falë përvojës, kapaciteteve dhe burimeve të duhura që lidhen me këtë fushë. Programi Bachelor në “Gjuhë Angleze” u hap në vitin 1994, si një program 4-vjeçar. Aktualisht programi ofrohet nga DGJH, pjesë e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe në përbërje të tij ka 17 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 1 Profesor i Asociuar, 14 Doktorë të Shkencave dhe 2 Docentë.</p> <p>Njësisia bazë që harton programet e studimit në bazë të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, pra në fushën akademike dhe kërkimore, është në të njëjtën linjë me fushën e përgjithshme të programit të studimit në këtë universitet.</p> <p>Ngarkesa e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” mbulohet në masën 98.5 % nga pedagogë me kohë të plotë.</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

8




programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ashtu siç u përmend më sipër, ka harmoni mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. <i>Shtojca 1.1; Shtojca 2.1; Shtojca 2.15; Shtojca 2.5; Shtojca 6.85</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Gjatë takimeve në institucion, konstatoam se ka një prirje për bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Kështu për shembull, shkëmbimi i mendimeve pasqyrohet edhe në mënyrën e hartimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programit. Përveç shkëmbimit të informacionit, përmendim dhe ndarjen e detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analiza e vazhdueshme e punës së tyre, e cila parashikohet dhe në Rregulloren e Organizimit Administrativ si dhe rregulloren mbi organizimin akademik. DGJH ka në përbërje të tij Grupin mësimor të Gjuhësisë, i cili fokusohet kryesisht në aspektet gjuhësore të programit dhe siguron cilësinë dhe përditësimin e vazhdueshëm të njohurive gjuhësore që ofrohen në gjuhën angleze dhe frënge. Grupi është formuar me Vendim Nr. 15, dt. 23.12.2013 të KADM dhe shkresën Nr. 2167/1, dt. 17.04.2014 të Ministrit të Arsimit. DGJH gjithashtu formulon propozime në lidhje me ndryshimet në kurrikul, kriteret e pranimit, kuotat e pranimit ¹ , rekrutimin e pedagogëve të jashtëm, pasurimin e fondit aktual të bibliotekës, etj. Pedagogët me kohë të plotë të DGJH janë gjithashtu të ndarë në grupe pune në përmbushje të ngarkesës së mbështetjes për institucionin.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.	



	<p>Përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve diskutohen në njësinë bazë. Megjithatë, duhet theksuar se DGJH nuk ka hartuar raporte të veçanta për mbarëvajtjen e secilës marrëveshje bashkëpunimi, por aktivitetet e kryera në kuadër të secilës si dhe ndikimi pozitiv i tyre është pjesë e raporteve të analizës vjetore të veprimtarisë së tij.</p> <p>Programi i studimit “Gjuhë angleze” nuk parashikon praktikë profesionale në kurrikulën e tij, duke qenë se synimi i këtij programi nuk është thjesht përgatitja e mësuesve të gjuhës angleze. Praktika profesionale është pjesë e programit të ciklit II dhe për këtë DGJH ka një marrëveshje bashkëpunimi, të përditësuar me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.</p> <p>Në kuadër të programeve të të nxënit gjatë gjithë jetës, alumni të diplomuar në ciklin II, ftohen të jenë pjesë e aktiviteteve të trajnimit të organizuar nga DGJH dhe FEF. Një rast i tillë është ai i zhvillimit të praktikës së një studenteje të përzgjedhur nga projekti World University Service.</p> <p><i>Shtojca 2.16,17,18; Shtojca 2.27; Shtojca 2.45; Shtojca 3.28; Shtojca 3.29; Shtojca 3.34; Shtojca 3.36; Shtojca 3.40; Shtojca 4.75; Shtojca 4.76; Shtojca 4.77; Shtojca 4.78; Shtojca 4.79</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Dokumentacioni i shqyrtuar tregon se studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit zhvillohet në gjashtë semestra (me nga 15 javë mësimore secili) dhe është i organizuar në lëndë/module që mbulojnë 30 ECTS në semestër. Gjithashtu, lëndët ose modulet, organizohen në
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri	



të gjerë profesionesh e specialitetesh.	leksione dhe/ose seminare.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” fuqizon studentët në përfitim të shprehive të nevojshme për një gamë të gjerë profesionesh, në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Studentët përballen dhe ushtrojnë një sërë shprehish të cilat janë në linjë me profesione të ndryshme ku ata synojnë të përfshihen.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Përveç formimit të shprehive të veçanta të studentët, programi i studimit synon të informojë studentin nëpërmjet moduleve të ndryshme dhe i pajis studentët me njohuri të thelluara të gjuhës në drejtim të shkencave të gjuhësisë, fonetikës, gramatikës dhe leksikologjisë angleze. Njohuritë detajohen gjithashtu në module të analizës semantike, varianteve gjuhësore, njohurisë së komunikimit, përkthimit dhe sociolinguistikës. Duhet vënë gjithashtu në dukje se aspekte të caktuara të njohurive të thelluara gjuhësore të gjuhës shqipe janë pjesë e kurrikulës, në mënyrë që studentët të aftësohen në studime të krahasuara.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit e pajis nxënësin me njohuritë e duhura dhe aftësitë bazë që atij i nevojiten për të zgjidhur probleme të ndryshme që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të profesionit apo studimit të një fushe të specializuar.
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se programi i studimit përmban të gjithë elementët e strukturës së saj, siç janë: kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; planin mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; programin lëndor; profilin e programit; diplomën dhe suplementin. Duhet theksuar se rregullorja e programit përmban informacion të detajuar lidhur me objektivat e programit dhe rezultatet e të nxënit, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, planin mësimor dhe stafin akademik përgjegjës, kriteret/kuotat e pranimit, rregullat e transferimit, format e kontrollit dhe të vlerësimit, fushat e kërkimit dhe rregullat e diplomimit, programet lëndore, etj.
	Çdo program lëndor ka të përcaktuar rezultatet e të nxënit dhe kompetencat që synohen të arrihen nëpërmjet veprimtarive formuese që zhvillohen gjatë vitit akademik. Ato hartohen nga

	titullari i lëndës, miratohen nga përgjegjësi i departamentit duke përcaktuar dhe ngarkesën mësimore të konvertuar në kredite. <i>Shtojca 1,2; Shtojca 2.12; Shtojca 2.4; Shtojca 2.5; Shtojca 6.93</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				√

Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore (Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë) dhe njësia bazë (Departamenti i Gjuhëve të Huaja) plotësojnë detyrimet ligjore e nënligjore për organizimin, strukturën akademike dhe vlerësimin e akreditimin.			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Në tre vitet e fundit akademike, 17-18, 18-19 dhe 19-20 , DGJH ka patur përbërjen si në vijim: 17 pedagogë me kohë të plotë (PAE) , me kualifikimin: 1 Prof. As., 14 Dr. dhe 2 Doc., dhe 8 pedagogë me kontratë (PAK) , me kualifikimin: 2 Dr., 1 Doktor në proces dhe 5 Msc.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	DGJH ka një përfaqësues në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, njëkohësisht pjesë e NJBSC në Universitet, i cili mbulon gjithashtu rolin e koordinorit të programit, për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e jashtëm në kuadër akreditimi. Koordinatori është caktuar me vendim të departamentit të gjuhëve të huaja.			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	GVJ konstaton se, bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, në procesin e mësimdhënies është përfshirë personel akademik me një formim më të lartë se cikli paraardhës, dhe gjithashtu edhe stafi i institucionit që ushtron funksione drejtuese, i plotëson kriteret e përcaktuara në ligj.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	GVJ, gjatë vizitës në Institucion, u njoh nga afër me stafin akademik me stafin administrativ dhe konstaton se ky staf i përbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune. <i>Shtojca 2.15; Shtojca 3.46; Shtojca 6.85; Shtojca 6.90</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				√



Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Në planin mësimor të programit të studimit, vihet re përcaktimi i lëndëve të programit të studimit të ndara sipas kategorive të ndryshme. Departamenti harton gjithashtu rregulloren e programit të studimit (shtojca 2.4), e cila përfshin elemente të tilla si: objektivat formuese, rezultatet e të nxënit sipas kategorizimit disiplinor, modelin e diplomës dhe suplementin, kategorizimin lëndor sipas udhëzimeve në fuqi dhe personelin akademik përkatës, programet e lëndëve, format e studimit dhe të vlerësimit, etj.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Plani mësimor i programit të studimit përcakton ndarjen lëndore/module sipas objektivave të rregullores. Ai pasqyron lëndët/modulet e ndara në vite akademike dhe semestra. Çdo lëndë/modul përfaqësohet me emërtimin e plotë, kodin, vitin/semestrin kur zhvillohet, orët në auditor (leksione/seminare/laboratorë), orë jashtë auditorit, detyrimin e shlyerjes dhe kreditet. Plani përcakton gjithashtu numrin e lejueshëm të krediteve për lëndët me zgjedhje për çdo vit akademik.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” strukturohet në lëndë dhe module, të ndara në vite e semestra ku kanë përkatësisht të shënuar ngarkesën mësimore të konvertuar në kredite.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Në planin mësimor përcaktohen informacionet e nevojshme për modulet e zhvilluara si: ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Bazuar në dokumentet e dorëzuara, plani mësimor ka të pasqyruar ngarkesën mësimore për çdo modul të ndarë në orë leksion dhe seminar. Këto informacione pasqyrohen në planin mësimor dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Procesi i informimit të studentëve është mjaft transparent. Studentët informohen rreth programeve të studimit, rezultatet e provimeve, detyrimeve, grafikët e provimeve dhe njoftimeve që lidhen me kriteret e pranimeve të nxënësve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	



	<p>Në bazë të dokumentit të dorëzuar, konstatohet dorëzimi i planeve kalendarike ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës, leksione dhe seminare ose ushtrime/laboratore. Rregullorja e programit të studentit përfshin kriteret, kuotat e pranimit dhe të transferimit/program i dytë.</p> <p>Programet lëndore hartohen nga pedagogu titullar i lëndës/modulit, në përputhje me përcaktimet e planit mësimor dhe objektivat e programit të studimit, por është gjithmonë në ndryshim të vazhdueshëm me qëllim përmirësimin e tij dhe këto ndryshime pasqyrohen në çdo vit akademik.</p> <p><i>Shtojca 1.1; Shtojca 1.2; Shtojca 2.12; Shtojca 2.4; Shtojca 2.5; Shtojca 3.28</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	E gjithë ngarkesa e programit shtrihet në 3 vite akademike nga 60 ECTS secili. Çdo vit mbulon 1500 orë (brenda dhe jashtë auditorit). Programi i studimit është organizuar sipas përcaktimeve të VKM 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, i ndryshuar. Plani mësimor përcakton gjithashtu ngarkesën e lëndëve me zgjedhje, frekuentimi i të cilave koordinohet në varësi të numrit të studentëve që i përzgjedhin.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Mënyra se si programi është strukturuar, duke parë konkretisht emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave, është në favor të studentëve pasi iu mundëson atyre njohuri dhe aftësi.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Objektivat e programit përfshijnë përgatitjen e një gjenerate të re të ekspertëve të gjuhës në fushën e gjuhës angleze, thellimin e njohurive gjuhësore me lëndë të natyrës formuese e karakterizuese dhe përgatitjen e studentëve për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në drejtim të profesionit të ardhshëm. Kjo arrihet nëpërmjet përzgjedhjes së lëndëve/moduleve, shpërndarjes në vite e semestra, vlerësimin në kredite e orë mësimore. Kurrikula është hartuar në mënyrë të tillë që studentët
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	
Kriteri 6. Programet e	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

14

<p>lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>të marrin njohuri të formimit bazë dhe kryesisht plotësuese në vitin e parë (25% - A, 45% - B, 30% C/D). Më tej, në vitin e dytë dhe të tretë, ata thellojnë njohuritë gjuhësore me lëndë të natyrës karakterizuese (60% karakterizuese) dhe në vitin e tretë 60% karakterizuese. Kjo iu jep mundësinë studentëve të zgjerojnë në mënyrë graduale njohuritë e thelluara gjuhësore dhe të aftësohen në studimin e gjuhësisë si shkencë e aplikuar.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ka të njëjtën bazë formimi teorik dhe praktik me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe është në përputhje me profilin e programit Bachelor.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi ofron lehtësira në sajë të shpërndarjes së drejtë të bërë mes formimit teorik dhe atij praktik, duke bërë më të lehtë arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunësuesve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Disiplinat i nënshtrohen ndarjes së mëposhtme: - Lëndë të formimit bazë (simboli A) - 36 ECTS; - Lëndë të formimit karakterizues (simboli B) - 96 ECTS; - Lëndë ndërdisiplinore (simboli C) - 24 ECTS/ 18 ECTS me zgjedhje; - Lëndë plotësuese (simboli D) - 18 ECTS; - Provimi i formimit (simboli E) - 6 ECTS.</p> <p>Lëndët/modulet janë në ndryshim të vazhdueshëm. Ndryshimet vijnë kryesisht si rezultat i nevojës për të përditësuar metodikën e të mësuarit të gjuhës së huaj, por edhe për t’iu afruar kërkesave të studentëve, nevojës apo diskutimeve me partnerë të tregut të punës dhe sugjerimeve të alumni.</p> <p>Të gjitha lëndët/modulet përzgjidhen duke pasur parasysh ndihmesën/shtytësën që ata do të japin në përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga ky program studimi.</p> <p>Një nga synimet e këtij programi është të mundësojë vijimin e mëtejshëm të studimeve. Duhet theksuar se në vitin e tretë të studimeve, aftësitë gjuhësore formohen në nivelin C2 dhe ndërkohë studentët marrin njohuri në lidhje me përdorimin e gjuhës së huaj dhe lidhjen e saj me shoqërinë. Këtë e plotësojnë lëndë të tilla si njohuri komunikimi, sociolinguistikë, stilistikë, hyrje në gjuhësi, histori e gjuhës, etj. Në këtë vit, lëndët me zgjedhje janë konceptuar që t’i ofrohen studentit në varësi të synimeve individuale për studime në ciklin e dytë.</p> <p><i>Shtojca 2.14; Shtojca 2.19; Shtojca 2.5</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">√</p>



Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga vizita në Institucionit, GVJ konstaton që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, përmbush kërkesat ligjore në fuqi pasi gjithë stafi ka kualifikimin e duhur dhe është i aftë për të drejtuar modulet mësimore të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në vitin akademik 2019-2020, në këtë program studimi, janë angazhuar 21 pedagogë me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As., 15 Dr/PhD., 2 Doc. dhe 2 Msc. dhe 1 pedagog me kontratë (PAK), me Msc.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik PAE mbulon 98.5 % të ngarkesës mësimore të programit, ndërsa stafi PAK mbulon 1.5 %.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar 21 pedagogë me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As., 15 Dr/PhD., 2 Doc. dhe 2 Msc., dhe 1 pedagog me kontratë (PAK), me Msc. Stafi akademik PAE mbulon 97 % të ngarkesës mësimore të programit, ndërsa stafi PAK mbulon 3 %.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në vitin akademik 2017-2018, janë angazhuar 21 pedagogë me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As., 15 Dr/PhD., 2 Doc. dhe 2 Msc., dhe 2 pedagog me kontratë (PAK), me Msc. Stafi akademik PAE mbulon 94 % të ngarkesës mësimore të programit, ndërsa stafi PAK mbulon 6 %.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, evidentohet se jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë "Profesor".</i></p> <p>Aktiviteti kërkimor i stafit akademik orientohet sipas fushave akademike kërkimore përkatëse dhe aplikimit të tyre në praktikën lëndore që mbulon secili pedagog. Në fillim të vitit akademik, stafi akademik me kohë të plotë bën parashikimin e ngarkesës vjetore në auditor dhe asaj jashtë auditorit dhe harton formularin e organizimit të kohës vjetore të punës.</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, ngarkesa në orë dhe numër lëndësh, për stafin PAE, në këtë program studimi varion nga 1-5 lëndë dhe 37-223 orë mësimore, ndërsa për stafin PAK 1 lëndë dhe 37 orë. Ndërsa ngarkesa totale, edhe në programe të tjera, për stafin PAE, varion nga 5-8 lëndë, dhe 267-433 orë. <i>Evidentohet</i></p>



	<p><i>se disa prej anëtarëve të stafit akademik mbulojnë një numër të madh lëndësh.</i></p> <p>Departamenti organizon seksione të informacioneve shkencore që kanë për qëllim aplikimin e kërkimit shkencor në fushë-disiplina të kurrikulës, apo që synojnë përmirësimin e formave të vlerësimit të përcaktuara në të.</p> <p>Departamenti ka në përbërje të tij një punonjës ndihmës akademik me karakter administrativ. Për ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me kurrikulën dhe vlerësimin e studentëve, DGJH komunikon me sekretarinë e FEF, në përbërje të së cilës janë 2 punonjëse.</p> <p><i>Shtojca 2.15; Shtojca 2.25; Shtojca 2.26; Shtojca 5.80</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Mësimdhënia dhe të nxënit zhvillohet në përputhje me kurrikulën, objektivat dhe rezultatet e të nxënit në bazën ligjore të institucionit dhe shprehen në rregulloren e brendshme të departamentit dhe në rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Për të parë nëse gjithçka shkon në përputhje të plotë me programin e studimit, ngrihen mekanizma monitorimi që përveç se monitorojnë, edhe vlerësojnë sistematikisht aftësitë e stafit akademik dhe qasjen e tij nga moduleve të programit.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kështu, Sektori i Kurrikulave dhe i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (SKVBC) bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore dhe shkencore. Ai është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune lidhur me përmirësimet e mundshme aty ku është e nevojshme.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësimi i stafit akademik, nuk realizohet vetëm nga mekanizmat monitoruese por edhe nga vetë studentët. Kjo bëhet nëpërmjet formave të ndryshme, ku ndër to mund të përmendim dhe anketimet. Pyetësorët që studentët plotësojnë në përfundim të modulit/lëndës janë një mekanizëm mbi të cilin bazohet vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Gjithashtu, evidentohet përdorimi i Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3, ku studentët gjejnë informacion në lidhje me lëndët që janë pjesë e kurrikulës së tyre, përshkrimin e detajuar të secilës sipas syllabuseve lëndore të miratuara në departament, format e vlerësimit, detyrimet e frekuentimit si dhe kriteret përbërëse dhe peshën përkatëse të vlerësimit të vazhduar.</p> <p>Lidhur me ankimimet, ankesat e studentëve shqyrtohen sipas procedurave të parashikuara në nenin 103 të Rregullores së Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore të Universitetit “Fan S. Noli”. Pasi strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie kanë mbledhur të dhënat nga të dyja palët, mekanizmat monitorues dhe studentët, këto të dhëna analizohen dhe bëhen publike.</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, në të cilin merr pjesë edhe një përfaqësues i studentëve, kryen analizën statistikore të të dhënave, bazuar në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me studentët. Rezultatet hidhen në një format standard të rezultateve të vlerësimit të brendshëm, pjesë e sistemit digjital.</p> <p>Ky sistem vlerësimi nuk synon asgjë tjetër veçse nxit dhe inkurajon personelin akademik në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Duhet theksuar se analizat e pyetësorëve diskutohen në mbledhje të hapura në njësinë bazë. Gjithashtu, personeli akademik inkurajohet për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes bërjes publike dhe shkëmbimit të informacionit shkencor në varësi të fushave përkatëse të studimit.</p> <p><i>Shtojca 1.1; Shtojca 1.2; Shtojca 1.4; Shtojca 1.16; Shtojca 1.20; Shtojca 2.4; Shtojca 2.6; Shtojca 2.13; Shtojca 3.14; Shtojca 3.39; Shtojca 3.43; Shtojca 3.44; Shtojca 3.47; Shtojca 6.94; http://www.unkorce.edu.al/sq/node/800</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret | **Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksione, seminare, punë praktike, kontrolle të plota apo të pjesëshme të njohurive, projekte/detyra kursi dhe kolokiume. Ato përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit dhe pasqyrohen në programet lëndore.</p>			
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Programi i studimit dhe personeli akademik përpiqen të sigurojnë forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies për të bërë të mundur kuptimin e programit të studimit nga të gjithë, duke marrë parasysh nevojat e studentëve. Kjo sigurisht bazohet në fushën dhe natyrën e programit të studimit dhe hapësirat që ajo lejon për të bërë të mundur diçka të tillë.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UNIKO mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Një nga prioritetet e këtij universiteti është kualifikimi në vazhdimësi i stafit akademik dhe e faktin këtë gjë nëpërmjet vënies në përdorim të metodave të shumëllojshme dhe fleksibël pedagogjike, që sigurisht janë në një linjë me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon lëndë në përputhje me kualifikimin shkencor dhe kërkimin e vazhduar shkencor. Kjo mundëson përditësimin e njohurive sipas specifikave përkatëse lëndore.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i metodologjisë së mësimdhënies kryhet vazhdimisht nga personeli akademik dhe nga studentët. Të dy palët analizojnë metodat dhe nxjerrin në pah pikat ku mund të kenë nevojë për përmirësime. I gjithë stafi akademik angazhohet në përmirësimin e elementëve përbërës të formave të transmetimit të dijeve dhe njohurive.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Siç pasqyrohet në programet lëndore dhe rregulloren e programit të studimit, orët mësimore zhvillohen përmes metodave të ndryshme të mësimdhënies, duke u përqendruar në përdorimin e metodave ndëraktive, projektet lëndore, nxitjen e të menduarit kritik, prezantim detyrash kursi, etj.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi i studimit nuk synon vetëm ofrimin e njohurive dhe dijeve të një fushe studimi të caktuar, por inkurajojnë autonominë e studentit të mbështetur nga mësimdhënësi, duke krijuar kështu një harmoni në raportin midis tyre. Studentëve u jepet mundësia për të përzgjedhur temën e detyrave të kursit si edhe temën e punimit të diplomës sipas fushave shkencore të përcaktuara në mbledhjen e departamentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√


Shtojca 1. 1; Shtojca 2.4; Shtojca 2.17; Shtojca 2.20; Shtojca 2.21; Shtojca 2.26; Shtojca 3.28; Shtojca 3.48; Shtojca 3.71



Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Programi i studimit e zhvillon aktivitetin në hapësirat e UNIKO, të disponueshme në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë. Këto ambiente plotësojnë kriteret e duhura për nga hapësira, cilësia, pastërtia dhe mirëmbajtja. Në këto ambiente përfshihen auditorë mësimi, ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ, ambiente për bibliotekë, sallë konferencash.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi që ambientet e UNIKO kanë sipërfaqe të mjaftueshme dhe aparaturat e nevojshme për aplikimin e njohurive teorike të marra. Mediateka dhe laboratorët vënë në përdorim të studentëve mjete të teknologjisë së informacionit. Vënia në dispozicion e mediatekës e bën edhe më objektiv e të dobishëm paraqitjen e informacionit shkencor, prezantimin e detyrave të kursit, të punimeve të diplomës si edhe të studimeve specifike. Laboratori është përdorur gjithashtu edhe për organizimin e webinarëve në të cilët studentët kanë qenë gjithashtu pjesëmarrës.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Gjithashtu, studentëve iu është vënë gjithashtu në dispozicion edhe platforma online Rosseta Stone.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Sistemi digjital i ruajtjes së të dhënave ESSE3 mundëson komunikimin mes pedagogëve dhe studentëve në lidhje me informacionin bazë lëndor dhe elementët e vlerësimit në të.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Institucioni siguron akses në internet për personelin akademik dhe studentët. Studentët kanë gjithashtu mundësinë të përdorin kompjuterë për të lehtësuar kërkimet studimore shkencore të studentëve.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Tekstet e përzgjedhura për të ofruar programin e studimit, mund të gjenden te Biblioteka e Fakultetit, ndërsa materialet shtesë si psh. prezantime në powerpoint, ose leksione të shkruara vihen në dispozicion të studentëve në formë fizike dhe elektronike, në mënyrë që të jenë të aksesueshme për të gjithë studentët. Duhet theksuar se kryesisht pedagogët titullarë kanë hartuar kursin e leksioneve që u vihet në dispozicion studentëve. Një pjesë e lëndëve kanë gjithashtu literaturë të botuar nga vetë pedagogët e departamentit. <i>GVJ sugjeron që, Institucioni, të vijojë me përditësimin e literaturës në funksion të këtij programi studimi dhe shtimin, brenda mundësive, të teksteve të disponueshme në bibliotekë.</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë vizitës në ambientin e bibliotekës, u konstatua një numër i
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e	



<p>komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>konsiderueshëm botimesh të botuara gjatë viteve të fundit, që lidhen me programin e studimit, të aksesueshme për studentët. Biblioteka e Fakultetit ka një fond prej 5644 titujsh, nga të cilat 2075 tituj janë për gjuhët e huaja. 48.6% e studentëve të programit “Bachelor” në “Gjuhë angleze” janë aktualisht anëtarë të kësaj biblioteke. Biblioteka përditësohet çdo vit me tituj shkencorë, fjalorë, tekste praktike të aftësive gjuhësore, botime të letërsisë britanike dhe amerikane, etj. Biblioteka është gjithashtu e pajisur me sete kompjuterësh që mundësojnë lidhjen e studentëve me bibliotekat online dhe shkarkimin e materialeve elektronike në dispozicion.</p> <p>Përveç materialeve fizike të përcaktuara në bazë të programit të studimit dhe materialeve që biblioteka ofron, përdoren dhe burime të tjera si libraritë on-line ku studentët kanë akses për kërkimin dhe shkarkimin e literaturave të huaja dhe shqiptare. Abonimi në bibliotekën online PROQUEST ka bërë të mundur përditësimin e vazhdueshëm të materialeve nga ana e pedagogëve si edhe zgjerimin e njohurive dhe sigurimin nga ana e studentëve të literaturës së sugjeruar nga pedagogët. Pjesë e burimeve të shfrytëzueshme të UNIKO është edhe libraria online “U-LIBRARY”, e cila siguron një tjetër mundësi për përditësimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore që u vihen në dispozicion studentëve.</p> <p>Studentëve iu mundësohet akses i plotë dhe i vazhdueshëm në infrastrukturën laboratorike të nevojshme për realizimin e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike.</p> <p>E-learning, të mësuarit interaktiv nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, është prezent dhe në UNIKO. Si një formë tjetër mësimdhënie, përtej asaj mësimdhënies në një sallë trajnimi tradicionale, E-learning mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. Abonimi në bibliotekën online PROQUEST ka bërë të mundur përditësimin e vazhdueshëm të materialeve nga ana e pedagogëve si edhe zgjerimin e njohurive dhe sigurimin nga ana e studentëve të literaturës së sugjeruar nga pedagogët. Pjesë e burimeve të shfrytëzueshme të UNIKO është edhe libraria online “U-LIBRARY”, e cila siguron një tjetër mundësi për përditësimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore që u vihen në dispozicion studentëve.</p> <p><i>Mund të punohet drejt përmirësimit të sistemit të komunikimit të brendshëm me qëllim aksesin e dokumentacionit elektronik dhe respektimin e hapësirën vetjake të dedikuar.</i></p> <p>Personeli akademik është në dispozicion të studentëve për t'i ndihmuar ata dhe udhëzuar në punimin e diplomës, duke filluar që nga përzgjedhja e temës, mënyra se si do të trajtohet dhe burimet e nevojshme për plotësimin e saj. Duhet theksuar se fushat e studimit</p>
--	--



	<p>dhe kërkimit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Studentëve që kanë të drejtë të mbrojnë provimin e diplomës me tezë, u bëhet e ditur lista e fushave të kërkimit. Ata kanë të drejtë të zgjedhin fushën në të cilën preferojnë t'i thellojnë studimet e tyre si edhe të përzgjedhin pedagogun me të cilin do të punojnë për realizimin e punimit të diplomës.</p> <p>Personeli akademik, nga ana tjetër, është përgjegjës për dhënien e mbështetjes akademike të duhur dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit arritjen e standardeve të larta të punimit. Të gjitha këtë elemente shprehen në Udhëzuesin Praktik për Hartimin e Punimit të Diplomës, i cili iu shpërndahet studentëve pas miratimit të propozimeve që paraqesin në departament.</p> <p><i>Shtojca 2.6; Shtojca 2.14; Shtojca 3.34; Shtojca 3.35; Shtojca 3.39; Shtojca 3.52; Shtojca 6.87; Shtojca 6.88; Shtojca 6.89; Shtojca 6.90; Shtojca 6.91</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë angleze” i nënshtrohet procesit të vlerësohet nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësim i cili ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve me njësitë kryesore/bazë. Gjithashtu, çdo element që lidhet me zbatimin e rregulloreve të studimeve monitorohet vazhdimisht nga vetë DGJH, nga organet vendimmarrëse, autoritetet drejtuese dhe ndiqet në vijimësi nga vetë personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Departamenti ka për detyrë sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe informimin e studentëve dhe personelit akademik për cilësinë e studimit që ofron. Kurrikula e programit të studimit rishikohet në bazë të propozimeve të departamentit, argumentet e të cilit mbështeten kryesisht në numrin dhe cilësinë e studentëve të regjistruar, si dhe në nevojën për të rinovuar ofertën akademike në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Metodat e reja inovative të mësimdhënies, që kanë në fokus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies janë pjesë e fokusit të departamentit dhe pedagogëve të lëndëve përkatëse.</p> <p>Gjatë gjithë vitit akademik, një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

22

përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>kërkimit shkencor. Sikurse u përmend edhe më sipër, personeli akademik trajnohet në mënyrë të vazhdueshme në përfitim e metodave sa më produktive për realizimin e një mësimdhënie cilësore. Departamenti angazhohet për pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim përditësimin e metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj, flimin e lektorëve të huaj për leksione të hapura (shtojca 3.53), nxitjen e mobiliteteve të stafit dhe studentëve, etj. Gjithashtu, duhet evidentuar se një pjesë e personelit akademik është aktualisht i përfshirë në procesin e plotësimit të dosjeve për tituj më të lartë akademikë.</p> <p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik sugjeron, teston dhe analizon metoda të reja në mësimdhënie. Gjatë fazës së eksperimentimit, vërehet nëse kjo metodë përmbush të gjithë objektivat dhe synimet e programit. Detyruar edhe nga situata gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, për realizimin e procesit mësimor u përdorën platformat Google Classroom, Zoom, Microsoft Teams, Moodle. <i>Ka hapësirë për më shumë punë në drejtim të testimit të metodave të reja në mësimdhënie, dhe analizës së efekteve dhe pritshmërive.</i></p> <p><i>Shtojca 1.20; Shtojca 2.16, 17, 18; Shtojca 3.28; Shtojca 3.31; Shtojca 3.38; Shtojca 3.41; Shtojca 3.42; Shtojca 3.43; Shtojca 3.47; Shtojca 3.52; Shtojca 3.53; Shtojca 5.80; Shtojca 6.85</i></p>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.				
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, të cilat u bëhen të ditura studentëve përmes komunikimeve nga pedagogu i lëndës, por gjithashtu edhe përmes çështjeve të Institucionit.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Stafi akademik informon në fillim të çdo semestri për kriteret e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Pedagogu i lëndës, pasi paraqet strukturën e lëndës dhe temat e saj, shpjegon dhe mënyrën e vlerësimit për modulën në fjalë. Aspekte të testimit dhe vlerësimit parashikohen në Rregulloren e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore si dhe në programet e lëndëve përkatëse. Provimi mund të zhvillohet në formë të ndryshme si psh. me shkrim, me gojë, nëpërmjet detyrave të kursit dhe përgatitjes vjetore apo prezantimeve të ndryshme. Kjo
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të ndryshme,	

duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	I armishmëri formash vlerësimi i jep mundësinë studentëve të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. <i>Shtojca 1.2; Shtojca 2. 14; Shtojca 3. 56</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√


Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Ashtu siç u përmend dhe më sipër, vlerësimi i studentëve për njohuritë e fituara bëhet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit akademik. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të një moduli gjatë një semestri akademik, reflektohet në zërin e vlerësimit të vazhduar dhe përbën 30% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Gjatë vizitës u konstatua që UNIKO përdor sisteme elektronike për të realizuar vlerësimin e studentëve nëpërmjet formave të ndryshme. UNIKO është pjesë e projektit “Clean Score”, të financuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, që lidhet me korrigjimin elektronik të tezave të provimeve; projekti është në fazën e parë të aplikimit dhe stafi akademik po trajnohet për formatin e tezave dhe funksionin e sistemit elektronik të korrigjimit.</p> <p>Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës (modulit) dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Përveç titullarit të lëndës, në komisionin e provimeve merr pjesë edhe një anëtar i dytë i cili mbikëqyr zhvillimin korrekt të provimit.</p> <p>Testimi i vlerësimit të njohurive në UNIKO nuk i nënshtrohet më sekretimit ose ndonjë forme tjetër kodifikimi pasi UNIKO ka nënshkruar një marrëveshje për zbatimin e Projektit “Clean score”, i cili ndihmon në korrigjimin e automatizuar të provimeve, duke rritur transparencën dhe cilësinë në vlerësimin e studentëve. (shtojca 3.60)</p> <p>Përtej vlerësimit të studentëve me notë, pedagogët japin komente/feedback që arsyeton vlerësimin e vendosur së bashku dhe këshilla për të ndihmuar studentin për një përvetësim sa më të mirë të njohurive, dijeve të marra. Duhet theksuar se rezultatet e provimit publikohen brenda afateve të përcaktuara në rregullore, brenda ditës në rastin e provimit me gojë dhe jo më vonë se 6 ditë pas provimit me shkrim.</p> <p>Gjatë procesit të vlerësimit, pedagogët mundohen të evitojnë kopjimin, ose plagjiaturën si nëpër provime ashtu dhe nëpër detyra kursi. Gjithashtu, Kodi i Etikës së universitetit përcakton elementët që konsiderohen shkelje të të drejtës së autorit dhe të kopjimit në</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për	



rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	provime, si dhe ndëshkimet në rastet e shkeljes së etikës akademike. [E 32]			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Pas vlerësimit të studentëve nga pedagogët e lëndës/modulit, bëhet hedhja e notave në sistem duke respektuar kohën e nevojshme të përcaktuar në rregulloren e programit akademik. Studentit i jepet e drejta e plotë për t'u njohur me vlerësimin, për të kërkuar një rishikim të vlerësimit, i cili bëhet nga pedagogu i lëndës apo nga një komision i specializuar në atë fushë/modul. Komisioni i provimit merr përsipër çdo ankesë të studentëve, i shqyrton ato dhe jep një përgjigje përfundimtare rreth vlerësimit. Çdo vendim i dalë nga ky komision dokumentohet dhe arkivohet. <i>Shtojca 1.2; Shtojca 1.6; Shtojca 1.22; Shtojca 2.20; Shtojca 3.60</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Gjatë tre viteve të ciklit të parë Bachelor, studentët marrin njohuritë bazë në disa fusha të ndryshme të cilat me kalimin e kohës i thellojnë këto aftësi duke i përgatitur ata nga ana profesionale. Në vitin e parë studentët marrin formim bazë kryesisht në lëndë që lidhen me njohuri në fushën e gjuhësisë (Hyrje në Gjuhësi, Fonetikë e Gjuhës Angleze, Morfologji Angleze). Këto lëndë detajohen më tej në vitin e dytë e të tretë me fusha më specifike studimi të Sintaksës, Leksikologjisë, Stilistikës, Përkthimit, Analizës Semantike, etj. Studentit i jepet gjithashtu mundësia e përfundimit të njohurive të gjuhës angleze pas formimit të plotë gjuhësor që marrin për fushat e ngjashme në gjuhën shqipe. Aftësitë profesionale gjithashtu thellohen edhe në aspektin praktik me qëllim përfundimin e aftësive gjuhësore nga niveli në nivel (Analizë Teksti, Aftësi të Foluri, Gjuhë e Shkruar). UNIKO i kushton rëndësi edhe aftësisë së studentëve në fushat si teknologjia e informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Njohuritë në fushën e teknologjisë së informacionit, studentët i përdorin në hartimin dhe prezantimin e detyrave të kursit, projekteve lëndore, etj. Pjesa më e madhe e lëndëve përfshijnë mjete të TIK në mësimdhënie. Ashtu siç u përmend dhe më sipër, studenti vlerësohet dhe për
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë	

<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>përgatitjen e tij semestrale/vjetore. Mund të përmendim diskutimin në seminare, angazhimin në praktikat laboratorike, kolektime, etj. Këto kompetenca dhe aftësi të fituara nga studentët, të cilat janë të paraqitura në programin e studimit, analizohen dhe shqyrtohen nga titullari i lëndës.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, personeli akademik ka për detyrë të bëjë një përmbledhje të programit të studimit, duke evidentuar tematikat kryesore dhe ato më të rëndësishme që studentëve do të ju nevojiten në kryerjen e tezës së provimit.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Përtej kornizës së programit të studimit, personeli akademik organizon dhe orë të hapura ose seminare me tematika specifike të cilat zhvillohen nga pedagogë të ftuar në lidhje me zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. Duhet theksuar gjithashtu se paraqitja e zhvillimeve të reja në literaturën moderne në lidhje me mësimin e gjuhës së huaj, realizohet nëpërmjet moduleve të trajnimit që DGJH ofron në Qendrën e formimit të vazhduar në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit reflekton një raport të drejtë mes teorisë dhe praktikës (respektivisht 773 orë/1574 orë) dhe orëve të studimit në auditor dhe atyre të studimit individual (2049 orë/2451 orë).</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Diskusimet dhe puna në grup për të interpretuar dhe zgjidhur problematikave/çështje të ngrita, mbështeten nga personeli akademik. Personeli akademik, nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore, së bashku me studentët krijojnë aftësi për kërkime të pavarura. Është personeli akademik ai që nxit idetë inovative të studentëve që shërbejnë në aftësimin e tyre, si dhe i inkurajon ata për t'i zhvilluar këto ide.</p> <p><i>Siç u përmend dhe më sipër, idetë nxiten, inkurajohen dhe mbështeten nga personeli akademik, por sigurisht që ky proces duhet thelluar më tej. Duhet theksuar gjithashtu se mund të realizohet mbështetje më e madhe financiare në drejtim të studentëve.</i></p> <p>Personeli akademik i UNIKO u jep studentëve mbështetje dhe në bazë të marrëveshjeve që zotëron me shkolla, siguron realizimin e pjesës praktike eksperimentale të ushtrimit të profesionit dhe punimit të diplomave. Ndërkohë, departamenti ka inkurajuar dhe lehtësuar procedurat e mobilitetit për studentët dhe stafin akademik të këtij programi me universitet pritëse, "St.Cyril and St. Methodius", Veliko Turnovo, Bullgari, Universitetin "Aleksandru Ioan Cuza", Iash, Rumania, si dhe ka mirëpritur gjithashtu studentë të huaj nga Universiteti "Aristotele" Selanik, Greqi.</p>



	Shtojca 2.5; Shtojca 3.31; Shtojca 3.49; Shtojca 3.50; Shtojca 3.51; Shtojca 6.92			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Për mënyrën se si do të zhvillohet vlerësimi përfundimtar apo mbrojtja e diplomës është hartuar një procedurë e posaçme, e aksesueshme nga të gjithë studentët. Rregullorja e organizimit të studimeve përcakton format e provimit të diplomës për studentët e ciklit të parë. Ndërkohë, forma dhe procedurat e këtij provimi detajohen në Rregulloren e brendshme të DGJH dhe në Rregulloren e programit të studimit. Studentët diplomohen me provim formimi të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Kriteret e ndarjes së studenteve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Fondi i pyetjeve të provimit të formimit përgatitet nga Departamenti dhe u vihet në dispozicion studentëve gjatë semestrit të parafundit. Gjithashtu, departamenti harton edhe listën e fushave prioritare të kërkimit dhe miraton temat e përzgjedhura nga studentët si dhe listën e pedagogëve udhëheqës, bazuar në propozimet e studentëve. Studentëve u vihet në dispozicion edhe udhëzuesi praktik për hartimin e punimit të diplomës. Në vitin akademik 19-20 në këtë procedurë u shtua elementi i mbrojtjes paraprake të fazës së parë të punimit, si një mënyrë për një orientim më të mirë të studentit lidhur me kërkimin e tij.</p> <p>Personeli akademik i udhëzon studentët të përqendrohen dhe të seleksionojnë vetëm në disa tematika specifike, duke iu vënë në dispozicion informacione, materiale shtesë të nevojshme. Ndërkohë, udhëheqësi shkencor, bazuar në manual, udhëzon, sugjeron dhe vë në dispozicion të studentit material bazë dhe plotësues me synim mbarëvajtjen e procesit të punës studimore të kryer prej tij. Në përfundim të punimit, udhëheqësi i diplomës vlerëson nëse studenti ka ndjekur udhëzimet për shkrimin dhe hartimin e punimit, gjykon nëse rezultatet e nxjerra kanë cilësinë dhe vërtetësinë e synuar dhe vendos nëse punimi në tërësi i përmbush kriteret e duhura për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p>Finalizimi i këtij vlerësimi, qoftë ai me shkrim apo me mbrojtje</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria	



përgjegjëse për arsimin.	diplome, bëhet nëpërmjet vendosjes së notës.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet që ka studenti në bazë të UNIKO, ai pajiset me diplomën “Bachelor” në “Gjuhë angleze”, e cila i vihet studentit në dispozicion së bashku me suplementin përkatës. Me kërkesë të studentit, atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni mban në formë të shkruar dhe elektronike të gjithë dokumentacionin e studentit, të cilat duhet t’i paraqesë sa herë që studenti kërkon informacione. Kështu, Departamenti depoziton kopje të printuar dhe elektronike të punimeve të diplomës së studentëve, si dhe gjithë praktikat e dokumentacionit të vlerësimit. <i>Shtojca 1.20; Shtojca 1. 21; Shtojca 2. 6; Shtojca 2. 7; Shtojca 2. 8; Shtojca 2. 9; Shtojca 2. 10; Shtojca 2. 11; Shtojca 2. 13</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mblidhen, ruhen dhe përditësohet nga vetë institucioni. Ai arkivon të gjithë informacionin që lidhet me organizimin e programit të studimit si dhe angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik. Sektori i Burimeve Njerëzore në Rektorat administron ruajtjen dhe përditësimin e të dokumentacionit të personelit akademik të DGJH. Ai arkivon një bazë të plotë të procedurave të punësimit, të kuadrit ligjor dhe dosjeve përkatëse, si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të	Disa prej dosjeve të personelit, të zgjedhura në mënyrë rastësore, u panë edhe gjatë vizitës në Institucion. Dokumentacioni që ndodhej

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

28

<p>institucionit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>në dosje përbëhej nga: CV; diplomat respektive dhe listë notash; dëshmi të gradave shkencore; dëshmi të gjuhës së huaj; dëshmi penaliteti; vlerësim punë nga punëdhënësi; certifikata trajnimi dhe pjesëmarrjeje në aktivitete të ndryshme; dokument identifikimi; librezë pune.</p> <p>Në përputhje me procedurat e punësimit të stafit, UNIKO ndërmerr kryerjen e hartimit dhe zbatimit të procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Ai parashtron në përputhje me ngarkesën mësimore, vendet e lira dhe harton kriteret bazë për këto vende. DGJH angazhohet në hartimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me procedurat e punësimit të stafit, të cilat janë të përcaktuara në Urdhrin e Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 25.03.2009, në kriteret e caktuara në Ligjin 80/2015 dhe në Statutin e Universitetit.</p> <p>Në rast rekrutimi të stafit akademik me kohë të plotë, departamenti bën propozimin për vendin e lirë dhe fushën përkatëse të mësimdhënies. Kriteret e veçanta hartohen nga Dekani, i cili ia përcjell kërkesën Rektorit. Ky i fundit bën shpalljen e konkursit në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në Programin e Transparencës në faqen e internetit të Universitetit. Dosjet e kandidatëve shqyrtohen sipas kritereve të shpallura dhe sistemi i pikëzimit përdoret për rankimin e tyre.</p> <p>Hartimi i këtyre procedurave rekrutimi dhe vlerësimi, që mbështeten në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, ka për qëllim seleksionimin e kandidatëve dhe përzgjedhjen e kandidatëve më cilësore dhe më të përgatitur.</p> <p>Ndërkohë, në fillim të çdo viti akademik, departamenti përcakton nevojat e veta për staf akademik me kohë të pjesshme. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin shpalljen e thirrjes për pedagogë me kohë të pjesshme, vlerësimin e dosjeve dhe renditjen e kandidatëve sipas kritereve të përcaktuara.</p> <p><i>Shtojca 1. 1; Shtojca 1.21; Shtojca 2. 23; Shtojca 2. 24; Shtojca 2. 5</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">√</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe</p>	<p>UNIKO ofron kapacitetet e nevojshme për krijimin e mjedisit dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al



mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Këtu përfshihen auditorët me pajisjet e nevojshme, amfiteatri, qendra e ekselencës, salla e konferencave, mediateka, laboratorët, biblioteka, etj.			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë vitit akademik, nga vetë institucioni, organizohen trajnime të ndryshme që përmirësojnë kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit. Ndërkohë, personeli akademik nxitet të marrë pjesë në mobilitete mësimdhënieje në institucione ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit. Gjatë takimit në institucion me personelin akademik, u informuam se përfundim të periudhës së mobilitetit, personeli akademik organizon takime për të ndarë përvojën e tyre.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Departamenti i Gjuhëve të huaja mundëson hapësira të nevojshme për trajnimin e stafit akademik, për një qasje sa më inovative në mënyrën e mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja. Kështu, organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e institucioneve si Agjencia e Kërkimit dhe Teknologjisë së Informacionit, Zyra Erasmus + në Tiranë, etj. Personeli akademik është trajtuar gjithashtu për përdorimin e llogarive në bibliotekat online U-Library dhe të platformës për mësimin e gjuhëve të huaja, Rosetta Stone.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në fillim të vitit akademik, stafi me kohë të plotë nënshkruan organizimin e kohës vjetore që përcakton ndarjen e ngarkesës vjetore për çdo pedagog. Përveç ngarkesës në auditor dhe veprimtarisë shkencore, personeli akademik mbulon gjithashtu edhe ngarkesën në mbështetje të institucionit. <i>Shtoca 1.1; Shtojca 1.2; Shtojca 2.26; Shtojca 3.43; Shtojca 3.44; Shtojca 3.47; Shtojca 3.54; Shtojca 3.55; Shtojca 4.75-4.78; Shtojca 6.91;</i> <i>https://bit.ly/3bii4zE; https://bit.ly/31Q4vnV;</i> <i>https://bit.ly/2Z0MFNo;</i> <i>https://bit.ly/2DmMFzF;</i> <i>https://bit.ly/32MRkU9;</i> <i>https://cleanscore.al/arkiva/1259</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.3


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron	Vizita ne ambientet e institucionit dëshmoi se institucioni ofron një

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

<p>mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>numër të mjaftueshëm laboratorësh, zyrash, klasash në proporcion me numrin e studentëve në programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Qëllimet e programit mbështeten nga një larmi pajisjesh mësimore të përshtatshme për zhvillimin e shprehive që synohen të zhvillohen nga lëndët e ndryshme që janë pjesë e programit të studimit. Duhet theksuar fakti se laboratorët e gjuhëve të huaja janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhëve të huaja.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës konstatoam se laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të përshtatshme për realizimin e kërkesave të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja është gjithmonë i gatshëm për të përmirësuar bazën materiale TIK. Përveç laboratorit ekzistues, është duke u instaluar edhe Laboratori Digjital i Fonetikës.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Programi i studimit nuk parashikon orë të praktikave profesionale pasi këto janë pjesë e ngarkesës mësimore të programit të ciklit të dytë. Megjithatë, infrastruktura në dispozicion të universitetit shfrytëzohet për orët me karakter praktik në lëndët/modulet e programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit u konstatoa se studentëve u vihen në dispozicion tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse që ndihmojnë në realizimin e programeve të lëndëve të programit të</p>



<p>e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>studimit Bsc. "Gjuhë Angleze". Përveç bibliotekës së fakultetit, studentët kanë gjithashtu akses në bibliotekën shkencore në rektorat. Studentët kanë të drejtë të regjistrohen pa pagesë dhe të përdorin literaturën e nevojshme në ambientet e bibliotekave sipas orareve të shpallura për secilën (08.00-16.00), orare këto të përshtatshme me oraret në të cilat zhvillohet procesi mësimor.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e cila siguron një numër shumë të larmishëm titujsh librash, revistash shkencore e materiale të ndryshme mësimore, i vjen në ndihmë çdo studenti dhe mundëson realizimin me sukses të programit të studimit. Bibliotekat janë të pajisura me lidhje internet dhe poste kompjuterësh të cilët mundësojnë aksesin e studentëve në biblioteka online, në të cilat UNIKO kryen abonim në: EBSCO dhe PROQUEST. Aksesin në këto biblioteka online për studentët është pa pagesë.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka pajisjet e nevojshme së bashku me programet kompjuterike për të ofruar një shërbim sa më cilësor dhe bashkëkohor për të gjithë studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Zërat e bibliotekës në mbështetje të programit të studimit pasurohen në mënyrë të vazhdueshme, mbështetur në kërkesat e anëtarëve të personelit akademik të lëndëve përkatëse, të cilat paraqiten më pas për aprovim në organin përkatës të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Aktualisht, biblioteka "Kongresi i Manastirit" disponon një fond prej 16018 titujsh. Prej tyre, rreth 2000 janë në gjuhë të huaj. Pjesë e fondit të bibliotekës janë edhe 180 kopje fjalorësh në gjuhë të huaj. Ndërkohë, biblioteka shkencore në rektorat ka një fond prej 3000 titujsh të shfrytëzueshëm nga studentët e gjuhëve të huaja, në formën e teksteve akademike, monografi dhe studime, fjalorë, etj. Pasuria e bibliotekave, sikurse thënë edhe më lart, u vërtetua edhe nga vizita e kryer në institucion.</p>			
<p>Studentët mund të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim edhe jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjithashtu, biblioteka ka kapacitet të mjaftueshëm duke marrë parasysh numrin e studentëve.</p>	<p><i>Shtojca 3.35; Shtojca 3.34; Shtojca 6.90; http://bit.ly/32HWnEK</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UNIKO dokumenton në databazat e saj të gjithë aktivitetin e kryer nga studentët që nga momenti i tyre i regjistrimit deri në diplomim. Institucioni përdor programin digjital të sistemit universitar ESSE3. Sistemi digjital ESSE3 siguron menaxhimin e provimeve, vlerësimeve, plotësimin e kriteve të hyrjes ose jo në provim; menaxhimin e provimeve semestrale dhe vjetore; printimin e listës së pjesëmarrësve në provim dhe deklarime të rezultateve të provimeve; raportimin mbi detajet e provimeve në nivel studentit dhe lënde.</p>			
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Përveç dokumentimit të të dhënave mbi studentët, sistemi i menaxhimit arkivon dhe administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi ESSE3 kontrollon autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; ruan privatësinë e të dhënave.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat, datat e provimeve, regjistrimi në provime dhe rezultatet e tyre administrohen nga sistemi i menaxhimit në bashkëpunim me stafin akademik dhe atë administrativ. Gjithashtu, sistemi ofron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ nëpërmjet aksesit që i jep dekanit dhe përgjegjës të departamentit të kontrollojnë hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriteve të vlerësimit, etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Për të pasur një panoramë të plotë të mbarëvajtjes së aktivitetit mësimor, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Departamenti i Gjuhës Angleze, si njësi përgjegjëse që ofrojnë këtë program studimi, sigurojnë në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit. Sistemi ESSE3 ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të universitetit.</p> <p><i>Shtojca 1.6:</i> https://www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do; https://www.unkorce.edu.al/sq</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni ka një raport financiar të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët për mbarëvajtjen e programit të studimit të paktën për një cikël studimor të plotë.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Hartimi i planit të financimit është kryer duke marrë parasysh disa objektiva siç janë: të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Çdo vit, universiteti i nënshtrohet një auditi për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen financiare. Nga ky proces, hartohet një pasqyrë financiare e cila përmban të gjithë rrjedhën e lëvizjes së burimeve financiare. Raporti financiar paraqitet prej administratorit të Universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Pas shqyrtimit të veprimtarisë së deritanishme, rezulton se dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Departamenti i Gjuhëve të Huaja u kushton vëmendje të vazhdueshme çështjeve që lidhen me pranimet e reja, përshtatjen e studentëve me mjedisin akademik, rolin e tyre në sigurinë e cilësisë të veprimtarisë akademike, nevojat e të nxënit dhe kompetencat e kualifikimit profesional, mobilitetet, etj. Studentët informohen vazhdimisht mbi çështje që lidhen me kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimin e studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtaritw akademike, kulturore, etj.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Çdo student apo kandidat për student gëzon barazi dhe të drejta të njëjta me të tjerët. Kjo garantohet nga politikat dhe procedurat që ndjek departamenti. Kështu, DGJH diskuton dhe miraton një vit më parë kuotat dhe kriteret e regjistrimit për kandidatët nga arsimit parauniversitar. Në këto kuota Departamenti parashikon edhe kuota për kandidatë nga shtesa në nevojë dhe shtetas të huaj. Propozimi miratohet në Dekanat dhe i përcillet për miratim Senatit Akademik. Pas miratimit përfundimtar, ky informacion publikohet në faqen e internetit të Universitetit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në faqen zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë gjenden të publikuara të gjitha kriteret e programit të ciklit të parë, të dytë si dhe kriteret e transferimit. Procesi i regjistrimit kryhet sipas procedurave dhe afateve të shpallura nga MASR. Sekretaritet mësimore lehtësojnë procesin e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Përpara çdo viti akademik, departamenti harton dhe publikon kriteret që do të merren parasysh përgjatë fazës së përzgjedhjes së kandidatë për t'u pranuar në programin "Bachelor". Çdo procedurë që lidhet me kuota dhe kriteret transferimi, aplikimi për program të
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

35

e të veçanta të programit të studimit.	<p>dytë dhe diplomimi miratohen si pjesë e rregullores së programit të studimit dhe iu bëhet e ditur studentëve të interesuar.</p> <p>Gjatë vitit akademik DGJH organizon veprimtari me karakter promovues me nxënës të klasave të 11^{ta} dhe 12^{ta} të shkollave të mesme të qytetit.</p> <p><i>Shtojca 1. 23; Shtojca 3. 29 Shtojca 3. 59 Shtojca 2. 4 Shtojca 3. 58 Shtojca 3. 48; http://www.unkorce.edu.al/; http://www.unkorce.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni; http://172.16.0.2/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf; http://172.16.0.2/rregulat-e-regjistrimit; http://172.16.0.2/kriteret-e-pranimit; https://www.unkorce.edu.al/sq/content/uniko-zhvilloi-fushaten</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			√

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon të gjithë studentët që ndjekin programin e studimit “Bachelor” në “Gjuhë Angleze” për të dhënat rreth moduleve, krediteve, mënyrës së vlerësimit, elementët e vlerësimit, përmbajtjen e lëndës. Njëkohësisht, informacioni publikohet edhe në sistem. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen edhe në strukturën e vitit akademik.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Procedurat e transferimit të studimeve dhe të aplikimit për një program të dytë, të njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve të mëparshme, kryhen sipas Urdhërit përkatës të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vitin përkatës. Pas diskutimit në departament, kriteret miratohen në Rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në faqen zyrtare të Universitetit të Korçës gjendet i publikuar i gjithë plani mësimor që shtrihet në të tre vitet. Aty përcaktohen qartësisht lëndët/modulet, ngarkesa mësimore e shpërndarë në leksione, seminare dhe elementë të tjerë vlerësimi, të cilat konvertohen në kredite.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Pas përfundimit të ciklit të plotë të programit të studimit, studenti ka të drejtë të diplomohet nëpërmjet mbrojtjes së një teze diplome ose me provim formimi. Në të dyja rastet, studenti informohet nga fakulteti për kriteret, procedurat e veçanta dhe mënyrën e realizimit të procesit të diplomimit. Studentët orientohen në lidhje me fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe fushën e studimit për punimin e diplomës në fillim të studimeve të vitit të fundit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjithashtu, informacion i përditësuar rreth Udhërrëfyesit për studentët, Qendrës rinore sportive, Këshillit të studentëve, Qendrës së Karrierës dhe Alumni, etj. mund të gjendet edhe në



	faqen zyrtare të Universitetit. Shtojca 1.2; Shtojca 2.4; Shtojca 3.30; Shtojca 6.93; http://172.16.0.2/sites/default/files/Katalogu%202019-2020.pdf			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi V.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Siç u përmend edhe më sipër, plani mësimor i programit të studimit është i publikuar online. Aty përcaktohen qartësisht lëndët/modulet, ndarja semestrale, ngarkesa mësimore e shpërndarë në leksione, seminare dhe elementë të tjerë vlerësimi, të cilat konvertohen në kredite.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Çdo fillim viti akademik, DGJH vendos në dispozicion të studentëve programin e studimit të ciklit Bachelor. Në të gjenden informacione rreth kurrikulës mësimore, planit mësimor, praktikave profesionale, planit kalendarik, kreditet, ndarja semestrale, orarit, etj.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Për komunikimin e brendshëm mes studentëve, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore, UNIKO përdor Programin e Digjitalizimit të Sistemit Universitar, ku mund të aksesohet i gjithë informacioni i sipërpermendur.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët gjithashtu, njihen edhe me strukturat e tjera që sigurojnë organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor si logjistika, infrastruktura dhe shërbime të tjera që institucioni ofron. Informacioni mbi programin e studimit është i aksesueshëm nga të gjithë personat e interesuar, edhe në distancë. <i>Shtojca 3. 56; Shtojca 3. 57</i>			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi V.4				
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm				

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

37



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni, nëpërmjet sekretarisë mësimore të fakultetit siguron ruajtjen e dokumentacionit, si dhe harton statistika vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar nga viti në vit.								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Çdo veprim pasqyrohet në dokumentacionin e institucionit, përfshirë këtu numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.								
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.	Struktura ruan informacion për ecurinë e studentit gjatë të gjithë viteve akademike deri në diplomimin e tij. Ajo dokumenton çdo gjë duke nisur që nga momenti i regjistrimit të studentëve, rezultatet e marra, vijueshmëria e procesit mësimor e deri në momentin e diplomimit.								
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të gjitha këto dokumentacione menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Gjithashtu, sekretaria mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa e-maili dhe ruan kontakte të vazhdueshme me studentët në raste njoftimesh.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Pasi mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm, departamenti harton një raport analitik ku kryesisht paraqiten problematika që lidhen me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Të dhënat personale të studentëve si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar në fakultet dhe rektorat. Informacioni i mësipërm dhe përpunimi i tij statistikor përdoret nga DGJH për analizën periodike mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, për shqyrtimin e ecurisë së tyre në kurrikulë, për ruajtjen e kontakteve të rregullta me alumni.								
	<i>Shtojca 2. 22; Shtojca 3.30; Shtojca 3.62; Shtojca 6.81; Shtojca 6.82; Shtojca 6.83; https://bit.ly/3bL0N2q; https://bit.ly/32k99uN; https://bit.ly/2RkbfUU</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>√</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				√
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			√						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe	Përveç stafit të specializuar, UNIKO sigurohet që të përfshijë dhe studentët ose përfaqësuesit e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, të cilat janë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe

atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	rregullatore. Kështu, çdo grup i sigurimit të brendshëm të cilësisë ka përfaqësuesin e studentëve në çdo njësi kryesore.			
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni siguron dhe garanton që pjesëmarrja e studentëve të jetë e denjë gjatë proceseve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik. Institucioni siguron funksionimin e Këshillit Studentor, i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit. Programi “Bachelor” në “Gjuhë Angleze” ka përfaqësuesit e vet në këtë organ, të cilët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit.			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Një tjetër faktor që merret parasysh gjatë hartimit të programit të studimit, është dhe ngarkesa akademike e studentëve në programin e studimit. Parashikimi i procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit përfshin njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Programi është hartuar konform udhëzimeve të MASR lidhur me ngarkesën mësimore, si dhe përputhjen e lëndëve dhe unifikimin e tyre deri në masën 80% me të gjitha universitetet e vendit që ofrojnë program të ngjashëm.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët, pjesë përbërëse e grupit të vlerësimit, marrin pjesë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në kuadër të sigurimit të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit. Studentëve u kërkohet të japin kontribut nëpërmjet sugjerimeve në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, duke pasur mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Gjithashtu, studentët ftohen që, në përfundim të lëndës, të plotësojnë pyetësorët mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve në çdo lëndë. Ata shprehin mendimin e tyre në lidhje me lëndën, ngarkesën, organizimin e orës së mësimin nga ana e pedagogut, metodologjinë dhe teknikat e përdorura, kontrollin e dijeve të studentëve, etj. <i>Shtojca 1.2; Shtojca 1. 17; Shtojca 3. 63; Shtojca 3. 64; Shtojca 3. 65</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të	Institucioni ka ngritur një sistem menaxhimi informacioni dhe shërbimi, duke iu gjendur pranë studentëve në çdo kohë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

39




studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, departamenti ka në dispozicion struktura që merren me këto çështje.			
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Duhet theksuar funksionimi i sistemit ESSE3, i njohur ndryshe si sekretaria online e studentit, ku çdo student ka llogarinë e tij.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Qendra e Karrierës dhe Alumni, e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Kjo zyrë është në funksion të maturanëve, studentëve dhe alumni. Qendra e Karrierës dhe Alumni siguron informim, trajnime të ndryshme si dhe orientim lidhur me tregun e punës apo vazhdimësinë akademike.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Përveç informimit të studentëve rreth karrierës, kjo zyrë mbledh dhe dokumenton të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Pra, një nga funksionet e kësaj Qendre është gjurmimi i studentëve të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin "Fan S. Noli".			
	<i>Shtojca 1. 1; http://www.unkorce.edu.al/</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësive përbëhen nga komisione të posaçme, të cilat në përputhje me aktet nënligjore për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ndërmarrin veprimtari për menaxhimin e cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur	Universiteti ka ngritur një rrjet të sigurimit të cilësisë, mbështetur në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

40

<p>dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>standardet shtetërore të Kodit të cilësisë për arsimin e lartë. Ky rrjet i cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (SKSC), i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (DKSCKSH). Aktiviteti kryesor i këtij sektori përqendrohet në zhvillimin e kurrikulave, përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë dhe në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. SKS funksionon në bazë të rregullores në formën e manualit, miratuar nga Senati Akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>SKSC përqendrohet në zhvillimin e programeve mësimore dhe vlerësimin institucional. Ndërkohë, funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si një organ kolegjal i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër janë përfaqësues të fakulteteve, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i SKSC. Pranë çdo njësie kryesore ngrihet edhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me përfaqësim nga çdo njësi bazë dhe nga organizmat studentore. Ndërkohë, Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka përfaqësuesin e tij në grupin GVB e njësisë kryesore.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Hartimi i politikës së qartë dhe ndjekja e procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve është në harmoni të plotë me qëllimin e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, lidhur me krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. Gjithashtu, Departamenti i Gjuhëve të Huaja kryen analizën e ecurisë së procesit mësimor dhe kërkimor, duke evidentuar drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë akademike në lidhje me qëndrueshmërinë e programeve tashmë në funksion, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregullores së programit të studimit, ngarkesat mësimore dhe burimet e literaturës, drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik, si dhe studentët si aktorë të rëndësishëm të proceseve të sipërpërmendura.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

Shtojca 1.1; Shtojca 1.5; Shtojca 2.16, 17, 18; Shtojca 2.20; Shtojca 2.22; Shtojca 3.46; Shtojca 3.65; Shtojca 3.66; Shtojca 3.67; Shtojca 3.68, 69, 70; Shtojca 3.72

Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në institucion ekzistojnë dhe janë funksionale njësi të posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Kështu, Sektori i Kurrikulave dhe Sigurisë është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit. Në këtë kuadër funksionon edhe NJSBC, e cila nëpërmjet kontolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, evidenton problematikat kryesore të lidhura kurrikulat.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Mekanizmat e proceset formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë përdoren gjerësisht në këtë institucion. Kështu, NJSBC, në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, mbikëqyr ecurinë e kurrikulave. Gjithashtu, pedagogët përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme dosjen e tyre mësimore.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në institucion gjejnë zbatim metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Këtu përfshihet monitorimi i vazhdueshëm nga personat përgjegjës apo autoritetet drejtuese, diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorët. Përveç pyetësorëve me studentët e viteve të ndryshme, realizohet edhe një pyetësor në rang universiteti nga SKC dhe NJSBC mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Dokumentimi i rezultateve të këtyre vlerësimeve është një proces periodik, i cili ndiqet nga bërja e njohur e tyre për autoritetet përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Analiza e të dhënave u bëhet e ditur pedagogëve të departamentit dhe diskutohet në mbledhjen e analizës vjetore të veprimtarisë së tij. Sugjerimet dhe komentet e studentëve merren parasysh në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në program.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në raportet e vlerësimit përfshihen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p><i>Shtojca 2. 18; Shtojca 2. 21; Shtojca 3. 29; Shtojca 3. 68; Shtojca 3. 69; Shtojca 3. 70; Shtojca 3. 71; Shtojca 3. 73; Shtojca 3. 74</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>



Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është ajo që menaxhon sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo gjë zhvillohet në mënyrë periodike dhe është e dokumentuar në vetëvlerësimin institucional. Koordinator i DGJH në këtë njësi bashkëpunon me anëtarët e tjerë të NJBSC në fakultet dhe harton Raportin e përvitshëm të sigurimit të cilësisë. Ky raport përmbledh analizën e të dhënave mbi programin e studimit, shqyrtimin e kriterëve të pranimit, prurjet e reja dhe nivelin përkatës, format e vlerësimit dhe provimin e formimit, kalueshmërinë, mbulimin lëndor nga stafi akademik, etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimit të programit të studimit, UNIKO përdor metoda të ndryshme, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamenti përdor metoda të ndryshme vlerësimi në kuadër të realizimit dhe vlerësimit të mbarëvajtjes së programit studimor. Ndër to mund të përmendim evidentimin e problemeve që lidhen me mësimdhënies, sigurimin e bazës së të dhënave, vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, etj. Ndërkohë, NJSBC së bashku me grupet e punës në nivel njësie bazë dhe kryesore bashkërendojnë punën në lidhje me mjetet, mekanizamt dhe procesin e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Metodatat e tërthorta lidhen me realizimin e sondazhe e pyetësorëve të studentëve, të atyre të diplomuara, të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p><i>Shtojca 2.18; Shtojca 2.22; Shtojca 3.28; Shtojca 3.40; Shtojca 3.41; Shtojca 3.40; Shtojca 3.43; Shtojca 3.44; Shtojca 3.49; Shtojca 3.66; Shtojca 6.84; Shtojca 6.92</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përbushjes</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				√



Standardi VL4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Departamenti i Gjuhëve të Huaja angazhohet në përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, përfshirë të diplomuarit nga ky program studimi, personalitete të njohura të fushës, vullnetarë të korpusit të paqes, etj.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në Manualin e cilësisë së Universitetit "Fan S. Noli, përcaktohen qartë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat që ka çdo aktor për vlerësimin e cilësisë, stafi akademik, bordi administrativ, studentët etj. Institucioni garanton kryerjen e këtyre detyrave dhe përgjegjësi të caktuara.</p>				
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC-ja organizon dhe monitoron veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në fakultet. Ajo përbëhet nga 6 anëtarë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 përfaqësues të personelit akademik; - 1 përfaqësues të studentëve; - 1 përfaqësues të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. 				
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DGJH ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DGJH ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.</p> <p>Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë.</p> <p><i>Shtojca 3.35; Shtojca 3.44; Shtojca 3.49; Shtojca 3.53</i></p>				
Shkalla e përmbushjes së	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="576 1881 774 1917">Niveli</td> <td data-bbox="778 1881 976 1917">Përmbushet</td> <td data-bbox="981 1881 1179 1917">Përmbushet</td> <td data-bbox="1184 1881 1382 1917">Përmbushet</td> </tr> </table>	Niveli	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Niveli	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

44


standardit	Përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				√

Standardi VL5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga kontrolli i bërë në faqen zyrtare të internetit të institucionit, rezulton se organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publikuar aty. Ndërkohë, studentët dhe të interesuarit e tjerë kanë gjithashtu akses në dokumentet që lidhen me politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit.			
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Gjithashtu, në faqen e internetit të fakultetit gjenden edhe vlerësimet e studentëve për programin e studimit, në përputhje me legjislacionin për konfidencialitetin e të dhënave personale dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Ndërkohë, në të mirë përmirësimin të mangësive e dobësive të evidentuara, rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash të shkruara nga grupi i vlerësimit.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UNIKO ofron mbështetje ndaj veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, si një proces i rëndësishëm që sjell përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Njësoj si më sipër, institucioni organizon takime me personelin dhe studentët dhe i informon ata rreth sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit. <i>Shtojca 3. 73; https://www.unkorce.edu.al/sq/node/800</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze”, të ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit tregon qëndrueshmëri, e evidentuar kjo nga vazhdimësia ndër vite dhe regjistrimet e studentëve.
2. Programi i studimit mbulohet nga staf i kualifikuar dhe që angazhohet në mësimdhënie sipas specializimit përkatës. Duhet theksuar se 98.5 % e programit të studimit mbulohet nga pedagogë me kohë të plotë.
3. Infrastruktura në shërbim të programit të studimit është e nivelit të lartë, përfshirë këtu laboratorin dhe bibliotekën.
4. Studentët angazhohen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rishikimin e kurrikulave.
5. Institucioni disponon mekanizma funksionale të sigurimit të brendshëm të cilësisë, me një ndikim të drejtpërdrejtë në këtë program studimi.

Pika të dobëta:

1. Nuk është realizuar një studim i mirëfilltë i tregut të punës për këtë program studimi.
2. Jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve i përkasin kategorisë “Profesor”.
3. Disa prej anëtarëve të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mbulojnë një numër të madh lëndësh.

Rekomandime:

1. Institucioni, të realizojë një studim të tregut të punës për programin e studimit, pasi kjo do të ndihmonte studentët në orientimin e tyre profesional.
2. Institucioni, të përcaktojë si titullarë të lëndëve/moduleve, personel akademik të kategorisë “Profesor”.
3. Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e lëndëve tek personeli akademik, me qëllim uljen e ngarkesës në numër lëndësh të personelit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi.

Conclusions of the review of first-cycle study program Bachelor in “English Language”, offered by “Fan S. Noli” University, Korçë

Strengths and affirmations:

1. The study program shows sustainability, shown by the over the years continuity and student enrollments.
2. The study program is covered by qualified staff, engaged in the teaching process in line with their respective specialization. It should be noted that 98.5 % of the study program is covered by full-time lecturers.



3. There is a high-level infrastructure serving the study program, including the laboratory and the library.
4. Students are involved in assessing the teaching quality and curricula review.
5. The institution possesses functional internal quality mechanisms, with a direct impact on this study program.

Weaknesses:

1. Lack of proper labor market research study for this study program.
2. Not all heads of subjects/modules pertain to the "Professor" category.
3. Some of the academic staff members involved in this study program teach a considerable number of subjects.

Recommendations:

1. In order to guide students in their professional orientation, the institution needs to conduct a labor market research for this study program.
2. The institution should appoint as subject/module heads, academic staff pertaining to the "Professor" category.
3. The institution should review subject distribution to the academic staff, in order to reduce the workload of the current academic staff engaged in this study program.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Leonard Danglli

2. Dr. Ergys Bezhani

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				√
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				√
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				√
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				√
VLERËSIMI TËRËSOR				√

